



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-11540/21 datë:26.05.2021



Npi – 01/151 datë: 03.06.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe neni 17 pika (p) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Pas diskutimit publik të organizuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport më datën 07.05.2021, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 03.06.2021, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR VENDOSJEN E SHTATORES TË KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK “ADEM JASHARI “ NË SHESHIN (TREKËNDËSHIN) E QYTETIT TË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 03.06.2021, Unanimisht aprovoi, Vendimin që Shtatoren e Komandantit Legjendar të UÇK-së “Adem Jashari” ta vendosë në “Sheshi i UÇK-së” (trekëndëshi) në qytetin e Shtimes.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

AC

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryesueses së Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj